1. Për realizimin e përgjegjësiave që dalin nga kjo marrëveshje e bashkëpunimit, palët pajtohen që të njoftojnë njëra-tjetrën në çdo kohë.
2. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit do të aplikohet derisa palët reciprokisht me shkrim nuk merren vesh ndryshe.
3. Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri do të zgjidhet me mirëkuptim dhe partneritet.
4. Me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, krijohen obligime të ndërsjella të palëve për realizimin e detyrave të tyre.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët, shtypet në dy kopje të barasvlefshme, nga një për secilën palë.

Prishtinë, 20/08/2024

Palët nënshkruese të marrëveshjes:

Kreshnik Radoniq

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

01 Nr.Br. 400/03-43241
Data/Datum 28.08.2024



Komuna e Lipjanit
Municipality of Lipjan
Opštine Lipljan

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Prishtinë, 28/08/2024

Duke u bazuar në nenet 10, 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 01 mars 2019), nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-208 për Parqe Industriale dhe Teknologjike, Shtojcën 12 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT PËR PROJEKTIN PARKU INDUSTRIAL NË LIPJAN

Palët nënshkruese

1. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e përfaqësuar nga Ministrja (në tekstin e mëtejme Ministria) dhe
2. Komuna e Lipjanit e përfaqësuar nga Kryetari (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është investimi për realizimin e projektit të Parkut Industrial në Lipjan, si dhe përcaktimi i obligimeve të Ministrisë dhe Komunës për realizimin e projektit në fjalë.

Neni 2

Financimi i projektit

1. Ministria do të financojë projektin/kontratën "Ndërtimi i infrastrukturës fizike në Parkun Industrial në Lipjan, faza e V" brenda kufijve buxhetor të paraparë në harmoni me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Kornizës Afatshkurtër të Shpenzimeve (KASH).
2. Vlera e parashikuar e investimit për ndërtimin e infrastrukturës fizike të këtij parku faza e V (pestë) do të jetë deri në 2,672,554.61 euro për realizimin e kontratës.
3. Nga vlera totale e investimit 2,672,554.61 euro, Ministria do të financoj 2,000,000,00 euro për vitet 2024 - 2026, ndërsa Komuna do të financoj 672,554.61 euro për vitet 2024 - 2026.
4. Vlera e saktë përfundimtare e projektit për ndërtimin e infrastrukturës fizike për Parkun Industrial në Lipjan, do të përcaktohet më kontratën ndërmjet Ministrisë dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur konform procedurave të legjislacionit në fuqi.
5. Në pamundësi të realizimit të punimeve konform vlerës financiare të paraparë ndër vite, vlera e mbetur e parealizuar e vitit paraprak do të planifikohet nga ana e Ministrisë dhe e Komunës me rastin e ndarjes dhe zotimit të mjeteve të vitit vijues, ku do të përllogaritet edhe vlera e borxhit të mbetur nga viti paraprak.

Neni 3

Përgjegjësitë e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

1. Ministria udhëheqë dhe realizon të gjitha procedurat e prokurimit për realizimin e projektit të hartuar nga ana e Komunës dhe do të nënshkruaj kontratën trevjeçare në pajtim me legjislacionin përkatës të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike. Mjetet e parapara në Nenin 2 do të ndahen nga Ministria vetëm për shpenzimet e realizimit të kontratës, konkretisht për punët e aprovuara nga mbikëqyrësi i projektit dhe menaxheri i projektit të përcaktuar konform vendimit të Ministrisë.
2. Pagesat do t'i bëhen operatorit ekonomik konform kontratës.

3. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e përfunduara në bazë të situacioneve të paraqitura nga operatori ekonomik të vërtetuara nga mbikëqyrësi i projektit dhe menaxheri i projektit të përcaktuar konform vendimit të Ministrisë.
4. Pagesat bëhen vetëm për aktivitetet e Parkut Industrial në fjalë dhe jo për ndonjë aktivitet tjetër.
5. Finalizimi i kontratës ndërmjet Ministrisë dhe operatorit ekonomik do të bazohet në raportin e pranimit teknik.
6. Ministria më kërkesë të Komunës dhe në raste tjera, kur kjo është e domosdoshme do të i dërgoj Komunës këto të dhëna:

6.1 Kopjet e kontratës;

6.2 Kopjet e raporteve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punimeve;

6.3 Detajet e pagesave të bëra sipas kontratës dhe

6.4 Dokumente dhe raporte tjera sipas nevojës.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës së Lipjanit

1. Komuna me vendim do të përcaktoj zyrtarin përgjegjës për koordinim me Ministrinë me qëllim të mbarëvajtjes së punimeve në teren.
2. Marrëdhëniet pronësore-juridike dhe sigurimi i punishtes janë përgjegjësi e Komunës.
3. Komuna është përgjegjëse për hartimin e projektit, përfshirë paramasën, matjet, etj., si dhe për funksionalizmin e projektit.
4. Pas përfundimit të kontratës dhe pranimit teknik të saj, Komuna e Lipjanit obligohet që të kujdeset për infrastrukturën fizike në aspektin e mirëmbajtjes, ruajtjes së investimeve, sigurimit të hapësirave dhe pagesave të komunalive.

Neni 5

Përgjegjësitë dhe zotimet e përbashkëta

1. Ministria ka autoritetin dhe përgjegjësin të lidh kontratën me operatorin ekonomik, i cili është vlerësuar sipas procedurave legislative dhe të përcaktoj menaxherin dhe mbikëqyrësin i cili do të menaxhoj dhe mbikëqyrë realizimin e projektit.
2. Menaxheri dhe mbikëqyrësi i përcaktuar nga Ministria si dhe zyrtari përgjegjës i përcaktuar nga Komuna për monitorim të punimeve kanë kompetenca të plota për ndërhyrje në rast që konstatojnë se punimet nuk janë në përputhshmëri me kontratën.

3. Mbikëqyrësi, menaxheri si dhe zyrtari përgjegjës do t'i raportojnë Autoritetit nga i cili është përcaktuar.

Neni 6

Shqetësimet shtesë të ngritura nga palët

1. Palët ndajnë shqetësimin e përbashkët lidhur me keqpërdorimet e mundshme, të cilat rrezikojnë udhëheqjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin dhe konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi.
2. Palët deklarohen se për çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm do të bëjnë njoftim zyrtar.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që mund të kenë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore. Ndonjë mosmarrëveshje apo kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes duke përfshirë përmbajtjen e saj, validitetin apo përfundimin e saj duhet të zgjidhet nga gjykata kompetente.

Neni 8

Amendamentet

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 9

Përfundimi

Palët mund të shkëpusin marrëveshjen me akt të njëanshëm duke dhënë 30 (tridhjetë) ditë afat me njoftim paraprak (arsyetim), në formë të shkruar palës tjetër.

Neni 10

Kopjet e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Rozeta Hajdari

Rozeta Hajdari

Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë



Imri Ahmeti

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit





Komuna e Lipjanit



Pranuar më:	05.09.2024	
Prilijeno:		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shifra Dodatak
01-320/01	44644	

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të

**Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, me regjistrim Nr: 5200122-6 –
përfaqësuar nga z. Zenel Bunjaku, Drejtor, në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”**

dhe

**Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti Kryetar i komunës, në tekstin e
mëtejme referuar si “Komuna e Lipjanit”**

I. Lënda e MpB

“IADK”-ja dhe “Komuna e Lipjanit” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Lipjanit.

Kjo MpB ka për qëllim të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-së dhe “Komunës së Lipjanit” gjatë vitit 2024 dhe 2025, bazuar në zbatimin e projektit **“Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë”** financuar nga Agjensioni Suedezi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar i përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë (Sida), Këshilli Danez për Refugjatët (DRC) do të menaxhojë fondet nga Sida kurse Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) do të implementoj projektin.

Projekti fillimisht do të ketë shtrirje në Komunën e Lipjanit dhe Leposaviqit dhe sipas nevojës edhe në komunat tjera të synuara në projekt; më konkretisht me komunën e Graçanicës, Novobërdës, Obiliqit dhe të tjera ku potenciali për përfshirjen e pakicave është i dukshëm.

Palët e lartë cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e IADK-së në zbatimin e projektit

IADK do zbatojë një numër të aktiviteteve me qëllim që komunitetet në Komunat e synuara të fillojnë dhe fuqizojnë aktivitetin e tyre bujqësorë dhe ekonomik me qëllim gjenerimit të të ardhurave dhe punësimit. Ky projekt ka në fokus mbështetjen e komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përfshirë edhe komunitet tjera. Intervenimet e projektit do të fokusohet në tre kategori të mbështetjes përgjatë vitit 2024 dhe 2025:

- 1) Ofrimin e mundësive të vetëpunësimit përmes granteve dhe këshillave praktike:
 - a) Grante për 100 përfitues (50 grante në vitin 2024 dhe 50 grante në vitin 2025);
 - b) Trajnime/këshilla direkte për të gjithë përfituesit e granteve;

Adresa:

S faraçak i Ulët nr.11

42000 Vushtrri

Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!

Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadk.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadk.org

D.B.

- IADK do të bashkëpunoj me kompanitë/bizneset private duke mundësuar dhe ofruar trajnime praktike, profesionale dhe vizita studimore për fermerët (të gjithë komuniteteve) bashkëpunues të kompanive në komunën përkatëse;
- IADK-ja do të punojnë ngushtë me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Lipjanit në monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të përfituesve/pjesëmarrësve.

III. Obligimet e "Komunës së Lipjanit" në përkrahjen e zbatimit të projektit

- Komuna e Lipjanit do të ofrojë mbështetjen profesionale në zbatimin e projektit, përfshirë edhe informacionet e ndryshme statistikore, demografike mbi bujqësinë, bizneset dhe përfshirjen e komuniteteve;
- Komuna e Lipjanit do të ofrojë hapsirën e nevojshme për organizimin e ngjarjeve të ndryshme të planifikuara në projekt (sesione informuese, trajnimet et), po ashtu do të siguroj hapsirë adekuate për vendosjen e materialeve informuese për fermerët dhe projektin;
- "Komuna e Lipjanit" do të emërojë një zyrtar që do të përfshihet në projektin e IADK-së dhe do të ndihmojë stafin e IADK-së me materialet e nevojshme, të jetë pjesë e zbatimit të projektit gjatë përzgjedhjes së përfituesve dhe monitorimit të projektit.
- "Komuna e Lipjanit" do të koordinojë punën me komunitetet lokale ku minoritetet janë më të përfaqësuara për të lehtësuar procesin e zbatimit të projektit;
- "Komuna e Lipjanit" gjegjësishtë departamenti për bujqësi dhe zyrja për komunitete do ti pranoj aplikacionet nga fermerët dhe do të nënshkrujë formën për pranimin e aplikacionit;
- "Komuna e Lipjanit" gjegjësishtë zyra për punësim do ti regjistrojë të interesuarit për punë sezonale në format të cilat i kemi dorëzuar mirëpo kjo nuk mund të evidentohet në statistikën e komunës si punësim pasi që kemi të bëjmë me punësim sezonal mesatarisht 15 ditë për një të pa punë;
- "Komuna e Lipjanit" sipas mundësive buxhetore do të përkrahë projektin "IADK"-në në bashkëfinancimin e projektit;
- "Komuna e Lipjanit" për çdo përfitues të përzgjedhur nga komuna e saj për grante do të kontribuojë në koston e projektit me maksimum 300 Euro për një përfitues të grantit me qëllim të rritjes së intensitetit të përkrahjes.
- Numri i përfituesve nga komuna respektive do të mvaret nga përmbushja e kritereve të caktuara nga projekti për kandidatët dhe është e ndarë në dy faza:
 - a) Faza e I do të realizohet gjatë vitin 2024 dhe
 - b) Faza e II do të realizohet gjatë vitin 2025
- "Komuna e Lipjanit" do të përkrahë projektin me bashkëfinancim në dy fazat e projektit.
- "Komuna e Lipjanit" mund të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e "Përfituesve/Pjesëmarrësve" edhe pas përfundimit të projektit.

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Është jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org



D.B

VI Personat Kontaktues

- "IADK"-ja dhe "Komuna e Lipjanit" do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshiheshin drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB.
- "IADK" do të përfaqësohet nga Z. Besnik Demiri si menaxher i projektit dhe kryesues i komisionit.
- "Komuna e Lipjanit" do të emërojë Z. Lulzim Qerimi nënkryetar i komunës si përfaqësues.

VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB vlen nga muaji 01.07.2024 deri më 15.11.2025, dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Në rast të zgjatjes së projektit palët për modifikimin e kësaj MpB duhet të vendosin para skadimit të afatit.

Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

VIII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 05/09/2024

Komuna e Lipjanit

Imri Ahmeti
Kryetari i Komunës

Lipjan 05.09.2024

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Është jelojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org

D.B

Pranuar me: Prilmeno: 03.09.2024		
Njësia Jednica	Numeri Broj	Shtojca Dodatak
01-560/03-44322		

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ndërmjet KOMUNA LIPJAN dhe OJQ
ORGANIZATA PËR FËMIJET PA KUJDES PRINDOR,**

Ky Memorandum Mirëkuptimi është një marrëveshje e bërë ndërmjet palëve të mëposhtme:

Komuna e Lipjanit, Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, Rr. Shqipëria nr, 28, 14000 Lipjan, Kosovë, dhe

Organizata për Fëmijët pa Kujdes prindëror me Numër të Regjistrimit 5115601-3 me adresë në Lagjen Lakrishte Sol. 1 Lok 3/1-Prishtinë-Kosovë, Drejtore Ekzekutive e organizatës znj. Ibadete Krasniqi, me dokument identifikimi Nr: 1004144488. OJQ OFAP është organizatë nacionale me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë. OFAP punon me synimin që çdo fëmijë të braktisur dhe pa kujdes prindëror t'i ofrohet një familje të jetoj, të rritet, të ndjehet pjesë e saj dhe të ketë dashurinë që i nevojitet.

Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden fëmijët në përgjithësi, me theks të veçantë, fëmijët e braktisur, keqtrajtuar dhe të neglizhuar, me qëllim të sigurimit të një familjeje strehuese për këta fëmijë. Misioni i OFAP është mbrojtja e fëmijës dhe fuqizimi i familjes në nevojë.

Për të arritur qëllimin më lartë, palët e lartpërmendura pajtohen si në vijim:

Objektivat e marrëveshjes:

- Palët nënshkruese i ndajnë parimet baze në mbrojtje të interesit më të mirë të fëmijës rreth përkujdesjes dhe mbrojtjes së fëmijëve në nevojë.
- Rritja në një familje edhe gjatë periudhës së përkohshme është mundësia e vetme e të jetuarit për fëmijët e braktisur, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore duke iu ofruar atyre mbështetje profesionale, emocionale dhe sociale për një zhvillim dhe rritje sa më të denjë në ambient familjar. E drejta të jesh fëmijë, e drejta të rritesh në familje, mision që e ka OJQ OFAP dhe bashkëpunon që 20 vite në komune në mbrojtje të interesit më të mirë të fëmijëve pa kujdes prindor.

Për arsyet e lartpërmendura, palët e konsiderojnë si themelor bashkëpunimin në kuadër të

periudhës së pacaktuar për mbështetje dhe ndihmë të fëmijëve të cilët për arsye të ndryshme familjare janë nën përkujdesjen e Qendrës për Punë Sociale të Lipjanit, dhe këtë nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit, mbikqyrjes dhe zhvillimit të formave familjare të mikpritjes për fëmijët pa kujdes prindor duke i realizuar ato sipas parimeve të partneritetit në mes të Komunës si institucion publik dhe OJQ OFAP.

Neni 1 **QËLLIMI**

Realizimi i mbështetjes dhe zhvillimit të nje **PLANI I VEPRIMIT PËR ZHVILLIM TË STREHIMIT FAMILJAR JASHT FAREFISI DHE MBËSHETJE TË STREHIMIT FAMILJAR BREND FAREFISI** në komunë të Lipjanit duke u bazu në Legjislacionin në fuqi në Kosovë me fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes aktiviteteve të përbashkëta të përqendruara në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe ofrimin e shërbimeve psikosociale të fëmijëve pa kujdes prindor që janë nën përkujdesjen e Qendrës për Punë Sociale.

Neni 2 **OBLIGIMET SPECIFIKE TË PALËVE NËNSHKRUESE**

Çdo palë në këtë marrëveshje ka obligime specifike në zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në vijim:

2.1 KOMUNA LIPJAN (Konkretisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale)

2.1.1 Bashkëpunim mes OJQ OFAP dhe Komuna Lipjan për mbështetje të Qendrës për Punë Sociale për fëmijët pa kujdes prindor, të braktisur, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore për arsye të ndryshme të vendosur në strehim familjar dhe në strehim tek farefisi.

2.1.2 Të ofrohet hapësira brenda QPS Lipjan për shërbime në Fuqizim të Familjes, në ofrim të seancave psikologjike për fëmijët në nevojë dhe psioedukim për familje në nevojë.

2.1.3 Do të pranojnë nga OJQ OFAP raporte kuartale për ecurinë e aktiviteteve të realizuara në Komunë të Lipjanit.

2.1.4. Bashkëpunim me QPS rreth organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere për strehim familjar

me komunitetet dhe qytetarët e Lipjanit.

2.1.5. Takime kordinuese me menagjer dhe kujdestar të fëmijëve pa përkujdesje prindërore për hartim të planeve individuale dhe ofrimin e shërbimëve nga ekipa multidisciplinare e OJQ OFAP.

2.2 OFAP- Organizata për fëmijët pa kujdes prindor

2.2.1 Ofrojë përkrahje teknike për QPS Lipjan në tërë komunën me fshtarat përreth me qëllim të inkurajimit dhe ngritjes së interesimit të tyre për zhvillim të strehimit familjar jashtë farefisit si dhe ngritjes së njohurive të tyre profesionale mbi vlerësimin, trajnimin dhe aprovimin e

familjeve strehuese, dhe trajnimeve të familjeve tek farefisi për kujdesin e fëmijëve me modulin e trajnimit standard bazë për strehim familjar.

2.2.2. Të ndihmojë drejtorin e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale në Lipjan, në përpilim të PLANIT TË VEPRIMIT LOKAL PËR ZHVILLIM TË STREHIMIT FAMILJAR në mënyrë që të punohet në sensibilizim të popullatës, në përzgjedhjen/rekrutimin dhe trajnimin e familjeve strehuese nga ana e nëpunësve të shërbimeve profesionale të QPS- se në bashkëpunim me OJQ OFAP.

2.2.3. Të themelohet brenda QPS Lipjan, Qendra për Fuqizim të Familjeve në parandalim të braktisjes, për këshilla të familjeve strehuese tek farefisi dhe familjeve strehuese potenciale jashtë farefisit në kuadër të QPS Lipjan.

2.2.4. Të sigurojë psikologun dhe ekipën multidisciplinare për mbështetje, rehabilitim dhe trajnim të nevojave të fëmijëve në strehim familjar dhe këshilla dhe trajnime me programe dhe module të ndryshme për familjet strehuese, adoptuese dhe atyre potenciale strehuese.

2.2.5. Takime kordinuese me menagjer dhe kujdestar të fëmijëve pa përkujdesje prindërore për hartim të planeve individuale dhe ofrimin e shërbimëve nga ekipa multidisciplinare e OJQ OFAP.

2.2.6. Të ndihmojmë familjet strehuese sipas mundësisë me ndihmë logjistike dhe ndihmë në ushqim e veshmbathje;

2.2.7. Paraqes raporte mujore, tre mujore për drejtorin e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe QPS, me rekomandime dhe plane për muajt e ardhshëm.

Neni 3

HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë vlen deri me 31.12.2024 dhe hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 4

PËRFUNDIMI

Kjo kontratë përfundon me:

- a) përfundimin e afatit të pajtuar,
- b) mospërbushjen e dukshme të obligimeve nga njëra ndër palët,
- c) pamundësia e zbatimit të qëllimit për të cilin është lidhur marrëveshja, meqë rast do të nënshkruhet një dokument në të cilin shpjegohen rrethanat që kanë çuar në përfundimin e marrëveshjes.

Neni 5

NDRYSHIMET E KONTRATES

Respektimi i kësaj marrëveshjeje është i obligueshëm për palët nënshkruese; kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pajtueshmërinë dhe kërkesën e palëve duke proceduar me nënshkrimin e një dokumenti përkatës.

Neni 6

Të tjera

6.1.1. Kjo marrëveshje përgaditet në dy versione origjinale, nga një për secilën prej palëve.

E nënshkruar në Lipjan, më ___/___/2024, në mes të Organizatës për Fëmijët pa Kujdes Prindor, Drejtore Executive Ibadete Krasniqi dhe Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti.

Znj. Ibadete Krasniqi

Drejtore ekzekutive OFAP



Z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit



Memorandumi i mirëkuptimit

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВА / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
MINISTRY FOR COMMUNITIES AND RETURN
MINISTRARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

Njësia orig./Org. Jednica/Orig. Unit: _____

Nr./Br./No. 2200/2 Data/Datum/Date: 03.09.2024

Nr. Faqeve/Br. Stranica/No. Pages: 4

FUSHË KOSOVË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno: 06.09.2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-352/01	44787	

Ministria për Komunitete dhe Kthim /
Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 mars 2019), bazuar në nenin 11 paragrafi 1 (nën-paragrafi 1.5) të Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 34 /18 nëntor 2022) , duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 (nën-paragrafi 1.14), Shtojcën 14 të Rregullores (QRK)-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 neni 58, nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit në mes të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) të cilën e përfaqëson ministri z. Nenad Rašić dhe Komunës së Lipjani, të cilën e përfaqëson kryetari z. Imri Ahmeti:

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Ndërmjet:

Ministrisë për Komunitete dhe Kthim
dhe
Komunës së Lipjani

Lidhur me:

Bashkë financimin e projekteve : 1. “Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksander Stipcevic”,
2. “Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjeve dhe Gadimë e Ulet”,
3. “Ndertimi i urës metalike në fshatin Hallaq i vogël”.

Neni 1

Qëllimi

Duke patur parasysh rëndësinë realizimit të këtij projekti për banorët e Komunës së Lipjani, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Komuna e Lipjani, nënshkruajnë këtë memorandum mirëkuptimi për realizimin e projekteve të lartcekur.

Neni 2

Mënyra e bashkëfinancimit

Ministria për Komunitete dhe Kthim nga shumat totale e projekteve në vlerë prej 160.000,00 € (njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro), do të merr pjese në vlerë prej 50% për realizimin e projekteve : 1.“Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksander Stipcevic”, në vlerë prej 35.000.00 2. “Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjeve dhe Gadimë e Ulet”, në vlerë prej 70.000.00 3.“Ndertimi i urës metalike në fshatin Hallaq i vogël” në vlerë prej 55.000.00.

Neni 3

Obligimet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK)

3.1. MKK e bënë zotimin e mjeteve për pjesëmarrje në projekt nga neni 2 i kësaj Marrëveshjeje - memorandumit dhe një kopje të zotimit duhet të dërgoj në Komunë.

3.2. MKK i bënë pagesat e para, pas dorëzimit të situacioneve ose situacionit për punët e kryera nga ana e kompanisë kontraktuese dhe pas kompletimit nga ana e zyrtarëve komunal përgjegjës, lëndët pranohen në MKK deri në shumën e pjesëmarrjes në projekt.

3.3. MKK cakton personin kontaktues lidhur me këtë projekt dhe informon Komunën.

Neni 4

Obligimet e Komunës së Lipjani (Komuna)

4.1. Komuna obligohet ti krijoj parakushtet e nevojshme për fillimin e realizimit të kontratës për projektet:1.“Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksander Stipcevic”, 2. .“Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjeve dhe Gadimë e Ulet”, 3.“Ndertimi i urës metalike në fshatin Hallaq i vogël”.

4.2. Komuna obligohet që projektet në fjalë, ti realizojë në pajtim me Ligjin e prokurimit Publik dhe të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;

4.3. Komuna kryen procesin e tenderimit, cakton komisionin e hapjes dhe vlerësimit të tenderit ku nga MKK-ja kërkon që të caktohet nga një anëtar për hapje dhe vlerësim;

4.4. Komuna emëron organin mbikëqyrës (sipas kushteve për emërimin dhe kushteve tjera të kontratës) për realizimin e këtij projekti, detyrë e të cilit është të bëjë mbikëqyrjen teknike dhe implementimin e projekteve sipas standardeve për punë sipas kontratës (kontrollon sasitë dhe kualitetin). Organi mbikëqyrës duhet të jetë profesional për punën që e mbikëqyrë;

4.5. Komuna obligohet që të njoftoj MKK-ën për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projekteve, dhe për këtë të kërkojë pëlqimin e MKK-ës;

4.6. Organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës;

4.7. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për projektet në fjalë për punët e kryera në nivel të financimit nga ana e MKK, duhet të kompletoj këto dokumente:

4.7.1. Kopjen e Kontratës së nënshkruar me Operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare të verifikuar nga origjinali prej menaxherit të prokurimit të komunës;

4.7.2. Vendimi mbi caktimin e organit mbikëqyrës nga ana e Komunës;

4.7.3. Raportet e organit mbikëqyrës mbi punët e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);

4.7.4. Faturat origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MKK-ja;

Memorandumi i mirëkuptimit

4.7.5. Kopjen certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik dhe

4.7.6. Raporti i pranimit (Forma e Thesarit – MEF) që përfshinë Konfirmimin për kryerjen e punëve që duhet të nënshkruhet nga MKK-ja nga personi kontaktues.

4.8. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundoj gjatë planit të paraparë.

4.9. Komuna është e obliguar të njoftoi MKK-ën për rrjedhat e realizimit të projekteve;

4.10. Sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit Komuna pagesat e para për projektet në fjalë do të kryej nga mjetet e ndara të MKK-së brenda vitit 2024.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumi të Mirëkuptimit

5.1. Ndryshimet eventuale duhet paraprakisht të akordohen në nivel të Ministrit të MKK-ës dhe Kryetarit të Komunës;

5.2. MKK-ja mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbushë obligimet e veta të dala nga ky memorandum i mirëkuptimit.

Neni 6

Arbitrazha

6.1. Palët do të përpiqen që të gjitha kontestet eventuale t'i zgjidhin në mënyrë të qetë dhe sipas marrëveshjes së nënshkruar.

6.2. Në rast të mos arritjes së Marrëveshjes, kontesti do të zgjidhet pranë Gjykatës kompetente.

Neni 7

Amendamentet dhe dispozitat e tjera

7.1. Ky Memorandum i mirëkuptimit mund të plotësohet ose të ndërrohet vetëm në formën e shkruar me pajtim të palëve të cilat do t'i bashkëngjiten si aneks kësaj Marrëveshje-memorandumi.

7.2. Marrëveshja është përpiluar në 2 (dy) kopje identike, nga një për secilën palë.

Neni 8
Palët

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (MM), është nënshkruar në mes të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe Komunës së Lipjani.

Për Ministrinë (MKK-në)

Nënshkrimi dhe vula:

Emri dhe mbiemri: Nenad Rašić

Pozita: Ministër i MKK-së

Vendi: Fushë Kosovë

Data: 03.09 2024

Për Komunën (Komuna e Lipjani)

Nënshkrimi dhe vula:

Emri dhe mbiemri: Imri Ahmeti

Pozita: Kryetar i Komunës së Lipjani

Vendi: Fushë Kosovë

Data: 03.09 2024

Memorandum o razumevanju

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA PER KOMUNITETE DHE KTHIM MINISTRY FOR COMMUNITIES AND RETURN MINISTARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRAKAK	
Njësia org./Org./Jednica/Org./Unit:	01
Nr./Br./No. 2200/2	Data/Datum/Datë 03.09.24
Nr. Faqeve/Br. Stranica/No. Pages: 4	FUSHË KOSOVË/A



REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA LIPLJAN		
Pranuar me: Prilijeno: 06.09.2024		
Njësia Jednica	Nr. Br.	Shënimi Dodatak
01-352/01-44787		

Ministria për Komunitete dhe Kthim /
Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

Ministar Ministarstva za zajednice i povratak, uz podršku člana 145 (tačka 2) Ustava Republike Kosovo, uzimajući u obzir članove 10 i 11 Zakona br. 06/L-113 o organizaciji i funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija (Službeni list, br. 7 / 01. mart 2019), na osnovu člana 11 stav 1 (podstav 1.5) Zakona br. 08/L - 117 za Vladu Republike Kosovo (Službeni list, br. 34 / 18. novembar 2022), na osnovu člana 4 stav 1 (podstav 1.14), Aneks 14 Uredbe (VRK)-br. 14/2023 za oblasti administrativne odgovornosti kabineta predsednika Vlade i ministarstava, kao i na osnovu Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 član 58, potpisan je memorandum o razumevanju između Ministarstva za zajednice i povratak (MZP) koju predstavlja ministar g. Nenad Rašić i opštine Lipjan koju predstavlja predsednik opštine g. Imri Ahmeti:

MEMORANDUM O RAZUMEVANJU

između:

Ministarstvo za zajednice i povratak

I

Opštine Lipjan

U vezi:

Sufinansiranje projekata: 1. „Uređenje kanalizacije u ulici Aleksandra Stipčevića“, 2. „Rekonstrukcija javne rasvete u Janjevu i Donje Gadimlje“, 3. „Izgradnja metalnog mosta u selu Mali Hallač“.

Član 1

Svrha

Imajući u vidu značaj realizacije ovog projekta za stanovnike Opštine Lipjan, Ministarstvo za zajednice i povratak i Opštine Lipjan, potpisuju ovaj memorandum o razumevanju za realizaciju navedenih projekata.

Član 2

Način sufinansiranja

Ministarstvo za zajednice i povratak od ukupnog iznosa projekata u vrednosti od 160.000,00€ (sto šezdeset hiljada evra), učestvovaće u vrednosti od 50% za realizaciju projekata: 1. „Uređenje kanalizacije u ulici Aleksandra Stipčevića“, u iznosu od 35.000,00 2. „Rekonstrukcija javne rasvete u Janjevu i donje Gadimlje“, u iznosu od 70.000,00 3. „Izgradnja metalnog mosta u selu Mali Hallač “ u iznosu od 55.000,00.

Član 3

Obaveze Ministarstva za zajednice i povratak (MZP)

- 3.1. MZP garantuje sredstva za učešće u projektu iz člana 2. ovog Sporazuma - Memoranduma i jednu kopiju garancije mora poslati Opštini.
- 3.2. MZP će izvršiti prve uplate, nakon dostavljanja situacija ili situacije završnih radova koje je izvršila ugovorna kompanija i nakon završetka od strane odgovornih opštinskih službenika, predmeti će biti primljeni u MZP-u do iznosa učešća u projektu.
- 3.3. MZP imenuje kontakt osobu u vezi sa ovim projektom i obaveštava Opštinu.

Član 4

Obaveze Opštine Lipjan (Opština)

- 4.1. Opština je dužna da stvori neophodne preduslove za početak realizacije ugovora za projekte: 1. „Uređenje kanalizacije u ulici Aleksandra Stipčevića“, 2. „Rekonstrukcija javne rasvete u Janjevu i donje Gadimlje“, 3. „Izgradnja metalnog mosta u selu Mali Hallač “.
- 4.2. Opština je dužna da predmetne projekte realizuje u skladu sa Zakonom o javnim nabavkama i Zakonom o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima;
- 4.3. Opština sprovodi tenderski proces, imenuje komisiju za otvaranje i procenu tendera, pri čemu traži od MZP-a da imenuje člana za otvaranje i procenjivanje;
- 4.4. Opština imenuje nadzorni organ (prema uslovima za imenovanje i drugim uslovima ugovora) za realizaciju ovog projekta, čiji je zadatak da vrši tehnički nadzor i realizaciju projekata po standardima za rad prema ugovoru (kontrolise količinu i kvalitet). Nadzorni organ mora biti stručan za posao koji nadzire;

Memorandum o razumevanju

- 4.5. Opština je dužna da obavesti MZP o svakoj predloženoj promeni količine i kvaliteta u toku realizacije projekata i da za to zatraži saglasnost MZP-a;
- 4.6. Nadzorni organ sa punom odgovornošću potvrđuje količinu i kvalitet izvedenih radova na osnovu kojih ekonomski operater izdaje finansijski dokument sa zahtevom za plaćanje izvršenih radova na osnovu uslova ugovora;
- 4.7. Opština se obavezuje da za isplatu predmetnih projekata za radove izvedene na nivou finansiranja od strane MZP-a, treba kompletirati sledeća dokumenta:
 - 4.7.1. Potpisana kopija Ugovora sa Ekonomskim Operaterom zajedno sa finansijskom ponudom overenu od originala od strane menadžera za nabavku u opštini;
 - 4.7.2. Odluka o imenovanju nadzornog organa od strane Opštine;
 - 4.7.3. Izveštaji nadzornog organa o izvršenim i odobrenim radovima (odobrene situacije);
 - 4.7.4. Originalne fakture od ekonomskog operatera i finansiranog iznosa od strane MZP-a;
 - 4.7.5. Kopija poslovnog sertifikata, bankovnog računa i lične karte vlasnika ekonomskog operatera i
 - 4.7.6. Izveštaj o prijemu (Obrazac Trezora – MEF) koji sadrži Potvrdu za izvođenje radova koju MZP mora potpisati i od strane kontakt osobe.
- 4.8. Opština mora preduzeti sve mere da bi projekat bio završen u predviđenom roku.
- 4.9. Opština je dužna da obavesti MZP o napretku projekata;
- 4.10. Prema ovom memorandumu o razumevanju, opština će izvršiti prve uplate za predmetne projekte koji su izdvojeni iz sredstava MZP-a u toku 2024. godine.

Član 5

Izmene i prestanak Memoranduma o razumevanju

- 5.1. Sve izmene moraju biti unapred dogovorene na nivou ministra MZP-a i predsednika opštine;
- 5.2. MZP ima pravo da obustavi korišćenje budžeta u ove svrhe u slučaju nalaza da Opština ne ispunjava svoje obaveze koje proizilaze iz ovog memoranduma o razumevanju.

Član 6

Arbitraža

- 6.1. Strane će nastojati da sve potencijalne sporove reše mirnim putem i u skladu sa potpisanim sporazumom.
- 6.2. U slučaju nepostizanja sporazuma, spor će se rešavati pred nadležnim sudom.

Član 7

Izmene i druge odredbe

Memorandum o razumevanju

- 7.1. Ovaj Memorandum o razumevanju može biti dopunjen ili izmenjen samo u pisanoj formi uz saglasnost strana, koji će biti priložen kao aneks ovog Sporazuma-memoranduma.
- 7.2. Sporazum je sastavljen u 2 (dva) istovetna primerka, po jedan za svaku stranu.

Član 8 Stranke

Ovaj Memorandum o razumevanju (MR) je potpisan između Ministarstva za zajednice i povratak (MZP) i opštine Lipjan.

Za Ministarstvo (MZP-a)

Potpis i pečat:

Ime i prezime: Nenad Rašić

Pozicija: Ministar MZP-a

Mesto: Kosovo Polje

Datum: 03.09 2024

Za opštinu (Opština Lipjan)

Potpis i pečat:

Ime i prezime: Imri Ahmeti

Pozicija: Predsednik Opštine Lipjan

Mesto: Kosovo Polje

Datum: 03.09 2024



Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPJAN

Pranuar me: 02.10.2024		
Priljet: 02.10.2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01320/01-48714		



Islamic Relief Kosova

Marrëveshje bashkëpunimi / Agreement

Ndërmjet / Between

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

dhe / and

Komuna e Lipjanit / Municipality of Lipjan

Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Lipjanit (Komuna) në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin Fuqizimi Bujqësor për Popullatat e Cenueshme në Kosovë në Komunën e Lipjanit që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër HQ0202514101 përkrahur nga zyra e Islamic Relief UK FAT.

Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

- 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim subvencionimin e fermerëve në Komunën e Lipjanit me paisje bujqësore.
- 1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e Komunës së Lipjanit.

Neni 2 Përshkrimi i projektit

For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Lipjan regarding the join of funds / donations for the project Agricultural Empowerment for Vulnerable Populations in Kosovo for the Municipality of Lipjan which is part of the IRW project with pin code number HQ0202514101 supported by Islamic Relief office in UK FAT.

Article 1 Purpose of the agreement

- 1.1 The purpose of this agreement is to determine the form of cooperation between IRW and the Municipality in order to implement and finalize the project that aims to support farmers in Municipality of Lipjan with agricultural equipments.
- 1.2 Beneficiaries of this project will be residents of the Municipality of Lipjan.

Article 2 Project description

2.1 Menaxhues i projektit është IRW në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 2.2 Participimi i Komunës do të bëhet me anë të transferit të mjeteve të komunës në llogarinë bankare të IRW, NLB 1708200008014285, pas nënshkrimit të marrëveshjes me qëllim të startimit të punëve, për projektin dhe fondet e zotuar të parapara në projekt për vitin 2024/2026, pastaj IR do të dëshmojë faturat e shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara. 2.3 Procedura e selektimit të fermerëve të cilët do të jenë përfitues të këtij projekti do të organizohet nga IRW & Komuna me komision për selektimin e fermerëve në bazë të kriterëve të krijuara nga Komuna së bashku me Islamic Relief Kosova. 2.4 Monitorimin, organizimin si dhe raportimin për kuantitetin si dhe kualitetin e shërbimeve do ta bëjë koordinatori/mbikëqyrësi i projektit i cili do të jetë në bashkëpunim të rregullt me Komunën.	2.1 The project is managed by IRW in cooperation with the Directorate of Agriculture, Forestry and Rural Development 2.2 The municipality's participation will be made by transferring the municipality's funds to the bank account of IRW NLB 1708200008014285, after signing the agreement in order to start work, for the project and the committed funds provided in the project for 2024/2026, then IR will prove the invoices of the expenses and the report of the services provided. 2.3 Procedures for selecting farmers which will be beneficiaries of this project, will be organized by the IRW & Municipality with the Commission for the Selection of farmers based on criteria established by the Municipality together with Islamic Relief Kosova. 2.4 Monitoring, organization and reporting on the quality and quality of services should be done by the project coordinator/supervisor who will be in regular cooperation with the Municipality.
Neni 3 Obligimet e palëve 3.1 Participimi financiar 3.1.1 Në kuadër të projektit me pin kod HQ0202514101 IRW do të sigurojë pjesën e fondeve në vlerë prej 19,076.09€ (nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë euro e nëntë cent) ose 52.94% të vlerës totale për implementimin e këtij projekti. 3.1.2 Në kuadër të buxhetit Komunal, Komuna do të participojë me kontribut financiar në shumën prej 16,956.52€ (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e dy cent) ose 47.06% të vlerës totale për implementimin e këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje. 3.1.3 Total vlera e projektit është 36,032.61€ (tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë e një cent), duke përfshirë fondet nga ana e Islamic Relief Kosova dhe Komuna e Lipjanit ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.	Article 3 Obligations of the parties 3.1 Financial participation 3.1.1 Within the project with pin code HQ0202514101 IRW will provide part of the funds in the amount of 19,076.09€ (nineteen thousand and seventy-six euros and nine cents) or 52.94% of the total value for the implementation of this project. 3.1.2 Within the Municipal budget, the Municipality will participate with a financial contribution in the amount of 16,956.52€ (sixteen thousand nine hundred and fifty-six euros and fifty-two cents) or 47.06% of the total value for the implementation of this project as presented in Annex A of this Agreement. 3.1.3 The total value of the project is 36,032.61€ (thirty-six thousand and thirty-two euros and sixty-one cents) including funds from Islamic Relief Kosovo and the Municipality of Lipjan as presented in Appendix A of this Agreement.
Neni 4 Përgjegjësitë e palëve	Article 4 Responsibilities of the parties

4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatorin e Programit si dhe e kundërta.

4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.

4.3 Koordinatorët do të jenë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

4.4 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 Koordinatorët

6.1 Koordinatori për IRW
Emri: Jetmira Zeka
Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10/ A
Prishtinë, Republika e Kosovës
Zyra Telefon: 038/232-431 /
Email: jetmira.zeka@ir-rks.org

6.2 Koordinatori për Komunë
Emri:
Adresa:
Telefoni:
Tel/Fax:
Email:

Neni 6 Gjuha zyrtare e marrëveshjes

7.1 Gjuha që mbizotëron në këtë marrëveshje është versioni në Gjuhën shqipe.

Neni 8

4.1 It is understood by both parties to this Agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa.

4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.

4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement.

4.4 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement.

Article 6 Coordinators

6.1 IRW Coordinator
Name: Jetmira Zeka
Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A
Pristina, Republic of Kosovo
Office Phone: 038/232-431 /
Email: jetmira.zeka@ir-rks.org

6.2 Coordinator for the Municipality
Name:
Address:
Phone:
Tel / Fax:
E-mail:


Article 6 Official language of the agreement

7.1 The language prevailing in this Agreement is the Albanian language version.

Article 8

Kohëzgjatja e marrëveshjes	Duration of the agreement
8.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit për Kosovë të Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë, dhe Kryetarit të Komunës së Lipjanit, dhe do të vazhdojë deri më 30 korrik 2025 kur pritet edhe të përfundojë realizimi i projektit.	8.1 This Agreement shall enter into force upon signature of the Director for Kosovo of the Islamic Relief Worldwide office in Kosovo, and the Mayor of Lipjan, and shall continue until 30th of July, 2025 when the implementation and monitoring of the project is expected to be completed.
Neni 9 Mosmarrëveshjet	Article 9 Disputes
9.1 Në rast të ngecjeve të realizimit të projektit palët pajtohen që të bëjnë ndryshimin e kësaj marrëveshjeje për një periudhë tjetër me aneks të ri të kësaj marrëveshjeje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.	9.1 In the event of project implementation delays, the Parties agree to amend this Agreement for another period with a new Annex to this Agreement in writing and signed by both parties.

Islamic Relief Worldwide – Kosova Office





Dr. Mohamed Soliman

Country Director Islamic Relief Kosova

Data/Date: 2/10/2024

Komuna e Lipjanit / Municipality of Lipjan




Z. Imri Ahmeti

Kryetar / Mayor

Data/Date: 02/10/2024

Pershkrimi Description	Total IRW & Lipjan			IRW		Komuna Lipjan		IRW	Lipjan
	Units	Price	Total	Units	Amount	Units	Amount	%	%
Multicultivators	17	1,250.00	21,250.00	9	€ 11,250.00	8	€ 10,000.00	53%	47%
Greenhouses 50m2	17	700.00	11,900.00	9	€ 6,300.00	8	€ 5,600.00	53%	47%
Indirekt 8%			2,882.61		€ 1,526.09		€ 1,356.52	53%	47%
Total:			36,032.61	€	19,076.09		€ 16,956.52	52.94%	47.06%

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Pranuar me:		
Priljeno: 07.10.2024		
Njësia Jednica	Namr Broj	Shtyca Dodatak
01-612/01-49304		



Kolegji AAB

CILËSI, LIDERSHIP, SUKSESI



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Kolegjit AAB

dhe

Komunës së Lipjanit

Duke u nisur nga interesi i përbashkët për avancimin e cilësisë së mësimdhënies e të shërbimeve arsimore në Kosovë. Bazuar në dëshirën për përparimin e shkëmbimeve arsimore në të mirë të rritjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore në Kosovë, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Kolegjit AAB dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës Nr.2855/117 të datës 13.12.2017. Me qëllim të krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit në dobi të studentëve, Kolegji AAB dhe Komuna e Lipjanit (tutje në këtë dokument: Palët) lidhin këtë MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI sipas dispozitave në vijim:

Neni 1

Bashkëpunimi përfshinë por nuk kufizohet në:

- Promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet të aktivitetëve të përbashkëta;
- Kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB në institucionet/departamentet, institucionet shëndetësore (QKMF), drejtoritë, agjencitë, institucionet shkollore dhe parashkollore të Komunës;
- Shkëmbimin e vizitave të organizuara tematike në dy drejtime nga nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit;
- Bashkëpunim dhe fushata tematike ndër-institucionale për të mirën e përgjithshme si: mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, shënimi i ditëve të ndryshme ndërkombëtare e kombëtare;
- Lehtësimi i implementimit të hulumtimeve e studimeve të ndryshme me rëndësi shoqërore, relevante për banorët dhe autoritetet e Komunës;
- Konkurimi i përbashkët në konkurse të ndryshme për projekte arsimore e hulumtuese në nivel komunal, kombëtar e ndërkombëtar;
- Organizimin e përbashkët dhe pjesëmarrjen në seminare, punëtori zhvillimore, e të tjera të karakterit rajonal e kombëtar në fushat e interesit të përbashkët;
- Organizimin e programeve të ndryshme nga ana e AAB-së për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve dhe të institucioneve të Komunës;
- AAB do t'i ofrojë stafit pedagogjik të shkollave të Komunës, pjesëmarrje në konferenca shkencore pa pagesë;
- AAB do të ofrojë hapësira për shfrytëzim pa kompensim nëse kërkohet nga Komuna për ndonjë aktivitet të organizuar;
- AAB do të organizojë kurse pa kompensim në kampuset e AAB-se, të gjithë maturantëve për përgatitje të testit të maturës;

- Komuna i lejon AAB-se organizimin e sesioneve informative për programet e studimit të AAB-se në shkollat e komunës përkatëse.
- AAB do të ofrojë trajnime për stafin pedagogjik të shkollave varësisht nga kërkesa e Komunës në fushën pedagogjisë, metodologjisë së mësimdhënies, kurrikulës etj;
- AAB do të ofrojë qasje pa kompensim në Teatrin “Faruk Begolli” për aktivitetet teatrale që organizohen nga Teatri “Faruk Begolli” për të gjithë stafin pedagogjik të shkollave dhe stafin e Komunës që vijnë në mënyrë të organizuar;
- AAB organizon aktivitete sportive në hapësirat e AAB-së për nxënësit e shkollave;
- AAB sipas mundësive do të përkrahë bibliotekën e qytetit përmes dhurimit të librave të ndryshëm të botuar nga shtëpia botuese e AAB-së;

Neni 2

Kjo Marrëveshje bashkëpunimit krijon parakushtet për bashkëpunim të mëtejshëm dhe mund të nënkuptojë nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera specifike për jetësimin e bashkëpunimit konkret në suaza të pikave të caktuara më lartë, për shembull në realizimin e punës praktike ose të ndërtimit të kapaciteteve.

Neni 3

Ekipet përkatëse nga të dy institucionet do të angazhohen në konsultime përgatitore dhe do të takohen për të operacionalizuar aktivitete të ndryshme të përbashkëta.

Neni 4

Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë pesë vjeçare nga momenti i nënshkrimit. Periudha e bashkëpunimit mund të vazhdohet me pajtim të ndërsjellë, përcjellë me nga një shkresë zyrtare nga të dyja palët dy muaj para skadimit të afatit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Palët mund të modifikojnë segmente të caktuara të bashkëpunimit me pajtim të ndërsjellë në një letër anësore për vazhdimin e afatit të bashkëpunimit.

Neni 6

Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje në gjuhën shqipe, ashtu që secila palë mban nga një kopje të marrëveshjes në origjinal.

Neni 7

Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen përmes negociatave të përbashkëta.

Kolegji AAB

Dr.Sc. Blerim Olluri
Rektor



Komuna e Lipjanit

Z. Imri Ahmeti
Kryetar





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

01 Nr.Br. 020/01-53012

Data/Datum 22.10.2024



MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT
mes
SHOQATA E MIQËSISË KOSOVË-AUSTRI
Dhe
KOMUNA E LIPJANIT

Për
SHËNIMIN E PËRVITSHËM TË DITËS SË
SHTETËSISË SË SHTETIT TË AUSTRIËS



Preambula

Ky memorandum i mirëkuptimit ka për qëllim sigurimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve nënshkruese. Me këtë rast, Shoqata e Miqësisë Kosovë - shpreh interesimin që të bashkëpunojnë me komunën e Lipjanit me rastin e shënimit të ditës së shtetësisë të shtetit të Austrisë, në shenjë dhe simbolik të rëndësisë së bashkëpunimit mes dy shteteve tona në lëmi të ndryshme, si dhe me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy shteteve mike.

Neni 1

Palët

Palë të këtij memorandumit janë Komuna e Lipjanit dhe Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri.

Neni 2

Qëllimi

Me nënshkrimin e këtij memorandumit palët dakordohen që të bashkëpunojnë me qëllim që të zbatohet objektivi i përcaktuar i këtij memorandum, përkatësisht shënjimi përvitshëm i Ditës së Shtetësisë së Austrisë në Komunën e Lipjanit më datën 26 tetor.

Neni 3

Zotimet e palëve

Në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Komuna e Lipjanit merr përsipër zotimin që me datën e lartcekur (26 tetor) të secilit vit të ngritë në shtizë para objektit të saj (objektit të Komunës) flamurin e shtetit të Austrisë, krahas flamurit shtetëror të Kosovës, në shenjë të respektit dhe miqësisë mes dy shteteve tona.

Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri merr përsipër që me rastin e nënshkrimit të Memorandumi të Mirëkuptimit të bëjë dorëzimin ceremonial dhe simbolik të flamurit të Austrisë tek Kryetari i Komunës Lipjanit.

Me rastin e nënshkrimit të këtij MM, komuna e Lipjanit nuk ka asnjë kosto apo obligim financiar.

Arsim VRANOVI

Avokat

President i Shoqatës Kosovë-Austri

Imri AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit





MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

në mes të

Komunës së Lipjanit

dhe

CNVP (Connecting Natural Values and People Foundation)

lidhur me

Mundësitë për sistemin e ngrohjes me biomasë

Hyrje dhe Përmbledhje

CNVP Kosovë po zbaton projektin “Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik” (SUNREED), i financuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë/Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) (2022-2026).

Projekti “SUNREED” synon të adresojë sfidat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, të mbështesë njerëzit që jetojnë në varfëri, të promovojë barazinë gjinore dhe të adresojë perspektivën e konflikteve. Projekti mbështet Pronarët Privatë të Pyjeve (PPP) dhe shoqatat e tyre në 23 komuna, si dhe Shoqatën Kombëtare të Pronarëve Privatë të Pyjeve (APPPK), për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve. Kjo do të bëhet përmes inkurajimit dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të menaxhimit të përmirësuar të pyjeve, zhvillimit të produkteve jo-drusore të pyjeve (PPJD), bimëve medicinale dhe aromatike (BMA), dhe sistemeve të zhvillimit të tregut për prodhimin e biomasës, duke kontribuar në përmirësimin e politikave, legjislacionit dhe gjenerimin e të ardhurave për PPP-të.

Neni 1 - Arsyeja

Ky Memorandum është rezultat i diskutimeve dhe propozimeve për bashkëpunim të iniciuara gjatë takimeve midis përfaqësuesve të Komunës së Lipjanit dhe CNVP-së, në kuadër të projektit SUNREED, për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe zhvillimin ekonomik përmes praktikave të mira të pylltarisë, prodhimit dhe përdorimit të biomasës drusore.



Neni 2 - Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit midis Komunës së Lipjanit dhe Fondacionit CNVP është vendosja e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve për prodhimin dhe përdorimin e biomasës drusore, si dhe menaxhimin e cilësisë për sistemet e ngrohjes me biomasë, përfshirë përgatitjen e një studimi fizibiliteti.

Neni 3 - Shtrirja e Bashkëpunimit

Ky Memorandum përfshinë bashkëpunimin midis Komunës së Lipjanit dhe CNVP-së në përgatitjen, organizimin dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm për zhvillimin e një koncept dokumenti (studim fizibiliteti) për prodhimin dhe përdorimin e biomasës drusore, si dhe menaxhimin e cilësisë për sistemet e ngrohjes me biomasë.

Neni 4 - Detyrimet e Komunës së Lipjanit

Komuna do të:

Sigurojë disponueshmërinë e informacionit të mjaftueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të aktiviteteve të projektit. Komuna do të:

Emërojë një zyrtar përgjegjës (koordinator) për zbatimin e aktiviteteve në lidhje me përgatitjen e dokumentit koncept (studim fizibiliteti);

Sigurojë informacionin përkatës për hartimin e koncept dokumentit;

Sigurojë pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit të punës dhe përfaqësuesve të tjerë komunalë në punëtoritë dhe takimet e organizuara për përgatitjen dhe diskutimin e konceptit;

Japë komente, ndryshime dhe propozime për finalizimin e dokumentit;

Përgatisë dhe paraqesë një propozim për institucionet financuese.



Neni 5 - Detyrimet e CNVP-së

CNVP do të:

Emërojë një pikë kontakti që do të angazhohet në aktivitete dhe do të jetë personi i kontaktit për Komunën;

Mbështesë Komunën në mbledhjen e informacionit përkatës për finalizimin e koncept dokumentit për sistemin e ngrohjes bazuar në biomasë drusore;

Ndihmojë në përgatitjen e koncept dokumentit ;

Sigurojë mbështetje teknike dhe logjistike në organizimin e punëtorive dhe takimeve me grupin e punës dhe përfaqësuesit e tjerë komunalë për përgatitjen dhe diskutimin e konceptit;

Kontribuojë me të dhëna dhe propozime të nxjerra nga diskutimet dhe konsultimet për finalizimin e dokumentit koncept;

Mbështesë Komunën në përgatitjen e dokumentit final për paraqitjen në institucionet financuese.

Neni 6 - Metodat e Bashkëpunimit

Për të arritur objektivat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të zbatojnë metodat e mëposhtme të bashkëpunimit:

Mbledhja e informacionit përkatës për përgatitjen e koncept dokumentit (studimi I fezibilitetit) për sistemin e ngrohjes;

Organizimi i diskutimeve të grupit të punës, takimeve dhe punëtorive;

Analizimi i dokumenteve ekzistuese për prodhimin dhe përdorimin e biomasës;

Shkëmbimi i të dhënave përkatëse përmes email-it dhe formave të tjera të komunikimit;

Përputhja me kërkesat ligjore sipas Ligjit për Mjedisin dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.



Neni 7 - Kordinimi

Secila palë, brenda pesë (5) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij MoU, do të caktojë një koordinator (pikë kontakti) përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve dhe bashkëpunimin e përcaktuar në nenet 3 dhe 4 të këtij MoU.

Palët do të informojnë njëra-tjetrën për koordinatorët e emëruar. Koordinatorët mund të zëvendësohen në çdo kohë nëse kërkohet.

Koordinatorët do t'u raportojnë mbikëqyrësve të tyre mbi përparimin e aktiviteteve në kuadër të memorandumit.

Neni 8 - Përputhja Ligjore

Ky Memorandum do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Ky Memorandum nuk do të shkelë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që dalin nga marrëveshje të tjera.

Neni 9 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet përmes mirëkuptimit dhe konsultimit të ndërsjellë midis Palëve.



Building a Greener Economic Environment

Neni 10 - Hyrja në Fuqi, Kohëzgjatja dhe Përfundimi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të mbetet në fuqi deri në arritjen e objektivave të dakorduara.

Memorandumi mund të përfundohet nëse njëra nga palët nënshkruese kërkon ndërprerjen e bashkëpunimit ose nëse ky memorandum zëvendësohet nga një memorandum tjetër.

Rënë dakord në Lipjan, Republika e Kosovës, më 23 Tetor 2024, në tre kopje origjinale.

Për

Komunën e Lipjanit

Imri Ahmeti

Kryetarë

Për

Fondacionin CNVP

Xhevat Lushi

Anëtarë i Bordit Ekzekutiv në CNVP

Drejtor për CNVP Kosovë





MEMORANDUM OF UNDERSTANDING

between

Municipality of Lipjan

and

Connecting Natural Values and People Foundation (CNVP)

on

Wood biomass district heating system opportunities

Introduction and background

CNVP Kosovo is implementing the project “Sustainable Use of Natural Resources for Environment and Economic Development” (SUNREED), funded by Embassy of Sweden in Prishtina/ Sweden International Development Aid (Sida) (2022-2026)

The “SUNREED” program regarding the environment and climate change, people living in poverty, gender equality and the conflict perspective, is supporting Private Forest Owners (PFO) and their associations in 23 municipalities and the National Association of Private Forest Owners (NAPFO) to improve their service delivery. The project aims to contribute to poverty reduction through additional income and jobs derived from sustainable forest management, promotion of biomass production for renewable energy, Non Wood Forestry Products (NWFP) and Medicine Aromatic Plants (MAPs), as well as carbon natural back up by enabling policy environment.

Article 1 - Rationale

This memorandum is a result of discussions and proposals for cooperation initiated during meetings between representatives of the Municipality of Lipjan and CNVP team within the project for SUNREED and the provision of good forestry, wood biomass production and use.



Building a Greener Economic Environment

Article 10 – Entry into force, duration and termination

This Memorandum will become effective when signed by both parties and remain valid until the achieved objectives.

The Memorandum may be terminated if one of the signatory parties asks for termination of the cooperation or when this memorandum is abrogated by another memorandum.

Agreed in Lipjan, Republic of Kosova, on 23rd of October 2024, in three original copies.

For

Municipality of Lipjan

Imri Ahmeti

Mayor

For

CNVP Foundation

Xhevat Lushi

Member of the Executive Board in CNVP

Director of CNVP Kosova



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRI E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 8454/24
Birr Prot. Prot. No.
Duke Datime Date:

Nr. i f. orig. 06
Org. Jedinica
No. i f. orig. 06
Ish. Shtetsh. No. i f. orig.

PRISHTINË / A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 23.12.2024
Prilijeno:

Njesia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-360/01-62719		

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova

Komuna e Lipjanit
Opština Lipjan
Municipality of Lipjan

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

NË MES

MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

KOMUNËS SË LIPJANIT

PËR

PROJEKTIN E BANIMIT SOCIAL ADEKUAT

Prishtinë
Dhjetor, 2024

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt.18.11.2022), Shtojcës 1, pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin “Banimi Social Adekuat”, neni 19 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, dhe 1.3, neni 24, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Kodi i Projektit 18987 - Programi i Banimit Social të paraparë në Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (Gazeta Zyrtare, Nr. 22/2024 dt.12 Dhjetor 2024), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr.28/04 Qershor 2008), si dhe Thirrjes Publike me Nr.314 të datës 06.12.2024 për Shprehje Interesi për Komunitet e Republikës së Kosovës, për Projektin e Banimit Social Adekuat, palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e përfaqësuar nga z. Liburn Aliu - Ministër (në tekstin e mëtejme MMPHI);

dhe

2. Komuna e Lipjanit, e përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)

lidhin:

MEMORANDUM TË MIRËKUPTIMIT PËR PROJEKTIN E BANIMIT SOCIAL ADEKUAT

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme “Memorandumi”) është të krijoj lidhje bashkëpunimi në mes MMPHI-së dhe Komunës për realizimin e Projektit të Banimit Social Adekuat (në tekstin e mëtejme “Projekti”).

2. Realizimi i Projektit bëhet përmes nën-projekteve¹ - komponentëve të Projektit në Komunë të cilat synojnë të përmirësojnë kushtet e banimit për grupet e synuara sipas Programeve të Veçanta të Banimit² për familjet ose individët të cilët nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit ose njësitë e banimit nuk i plotësojnë kushtet elementare për banim dhe kanë nevojë për rindërtim ose renovim. Gjithashtu ky Projekt është në përputhje me politikat e MMPHI-së për zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në njërën anë, si dhe në funksion të ushtrimit të suksesshëm të përgjegjësisë të hartimit, zhvillimit dhe menaxhimit të politikave, programeve dhe projekteve të banimit nga MMPHI dhe Komuna të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

¹ Nën-projektet në kuptim të këtij Memorandumi janë kategoritë e radhitura në nenin 2 paragrafit 2 të parapara në Marrëveshjen e kredisë e ratifikuar me Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë. Nën-projektet në Marrëveshjen e ratifikuar janë emëruar si Komponentët e Projektit (komponenti 1 dhe komponenti 2).

² Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Palët pajtohen që të përcaktojnë parimet e bashkëpunimit, rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të Projektit përmes nën-projekteve, në dobi të familjeve ose individëve të cilët kanë nevojë për ndihmën e shtetit, përmes zbatimit të Projektit për vitet 2025-2027.

2. Ky Memorandum ofron mundësi për Komunën që të përfitoj nga MMPHI financimin për realizimin e nën projekteve, të përzgjedhura nga Komuna pas shprehjes së interesit në "Thirrje për shprehje interesi për Komunitet e Republikës së Kosovës për Projektin e Banimit Social Adekuat", si në vijim;

2.1. ☒ Ndërtimin e projekteve (njësive banesore) të reja për banim social;

2.2. ☐ Renovimin e njësive ekzistuese të banimit social;

2.3. ☐ Rindërtimin apo renovimin e shtëpive private për familjet e cënueshme.

Neni 3 Mënyra e financimit

1. MMPHI, do të sigurojë financimin³ e nevojshëm për Komunën për realizimin e Projektit përmes nën-projekteve sipas Ligjit Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin "Banimi Adekuat Social" dhe Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 dhe 2027.

2. Financimi nga MMPHI dhe shuma për Komunën për zbatimin e Projektit përmes nën-projekteve, sipas paragrafit 2 të Nenit 2 të këtij Memorandumi, do të përcaktohet pas shqyrtimit të projekt-propozimeve dhe aplikimeve nga Komuna, vizitave në terren, koordinimit me palët përkatëse dhe hartimit të raporteve për miratim të projekt-propozimeve nga aplikimi.

Neni 4 Përgjegjësitë e MMPHI-së

1. MMPHI, ka përgjegjësi për:

1.1. Koordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin për shpërndarjen dhe përdorimin e financimit të nën projekteve në përputhje me rregulloret dhe procedurat sipas Marrëveshjes së kredisë e ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës

(BZHKE) për projektin "Banimi Social Adekuat përmes Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP);

³ Financimi për Komunitet dedikohet vetëm për investime kapitale

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum është i vlefshëm nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e suksesshëm të Projektit.
2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim ose përditësim të nevojshëm që ndikon në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Memorandum.

Për Ministrinë e Mjedisit
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës


Liburn ALIU
Ministër i MMPHI-së



Për Komunën e Lipjanit


Imri AHMETI
Kryetar i Komunës së Lipjanit



Datë: 23 Dhjetor 2024, Prishtinë

REPUBLICA E KOSOVË
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURË
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
PRISHTINË / A

M-01
06

8454/24

Prishtinë / A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLICA E KOSOVË
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: 23.12.2024
Primijeno:

Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-360/01-62719		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova

Komuna e Lipjanit
Opština Lipjan
Municipality of Lipjan

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES

MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

KOMUNËS SË LIPJANIT

PËR

PROJEKTIN E BANIMIT SOCIAL ADEKUAT

Prishtinë
Dhjetor, 2024

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt.18.11.2022), Shtojcës 1, pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin “Banimi Social Adekuat”, neni 19 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, dhe 1.3, neni 24, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Kodi i Projektit 18987 - Programi i Banimit Social të paraparë në Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (Gazeta Zyrtare, Nr. 22/2024 dt.12 Dhjetor 2024), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr.28/04 Qershor 2008), si dhe Thirrjes Publike me Nr.314 të datës 06.12.2024 për Shprehje Interesi për Komunitet e Republikës së Kosovës, për Projektin e Banimit Social Adekuat, palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e përfaqësuar nga z. Liburn Aliu - Ministër (në tekstin e mëtejme MMPHI);

dhe

2. Komuna e Lipjanit, e përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)

lidhin:

MEMORANDUM TË MIRËKUPTIMIT PËR PROJEKTIN E BANIMIT SOCIAL ADEKUAT

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme “Memorandumi”) është të krijoj lidhje bashkëpunimi në mes MMPHI-së dhe Komunës për realizimin e Projektit të Banimit Social Adekuat (në tekstin e mëtejme “Projekti”).

2. Realizimi i Projektit bëhet përmes nën-projekteve¹ - komponentëve të Projektit në Komunë të cilat synojnë të përmirësojnë kushtet e banimit për grupet e synuara sipas Programeve të Veçanta të Banimit² për familjet ose individët të cilët nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit ose njësitë e banimit nuk i plotësojnë kushtet elementare për banim dhe kanë nevojë për rindërtim ose renovim. Gjithashtu ky Projekt është në përputhje me politikat e MMPHI-së për zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në njërin anë, si dhe në funksion të ushtrimit të suksesshëm të përgjegjësisë të hartimit, zhvillimit dhe menaxhimit të politikave, programeve dhe projekteve të banimit nga MMPHI dhe Komuna të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

¹ Nën-projektet në kuptim të këtij Memorandumi janë kategoritë e radhitura në nenin 2 paragrafi 2 të parapara në Marrëveshjen e Kredisë e ratifikuar me Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë. Nën-projektet në Marrëveshjen e ratifikuar janë emëruar si Komponentët e Projektit (komponenti 1 dhe komponenti 2).

² Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Palët pajtohen që të përcaktojnë parimet e bashkëpunimit, rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të Projektit përmes nën-projekteve, në dobi të familjeve ose individëve të cilët kanë nevojë për ndihmën e shtetit, përmes zbatimit të Projektit për vitet 2025-2027.

2. Ky Memorandum ofron mundësi për Komunën që të përfitojë nga MMPHI financimin për realizimin e nën projekteve, të përzgjedhura nga Komuna pas shprehjes së interesit në "Thirrje për shprehje interesi për Komunitet e Republikës së Kosovës për Projektin e Banimit Social Adekuat", si në vijim;

- 2.1. ☒ Ndërtimin e projekteve (njësive banesore) të reja për banim social;
- 2.2. ☐ Renovimin e njësive ekzistuese të banimit social;
- 2.3. ☐ Rindërtimin apo renovimin e shtëpive private për familjet e cënueshme.

Neni 3

Mënyra e financimit

1. MMPHI, do të sigurojë financimin³ e nevojshëm për Komunën për realizimin e Projektit përmes nën-projekteve sipas Ligjit Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin "Banimi Adekuat Social" dhe Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 dhe 2027.

2. Financimi nga MMPHI dhe shuma për Komunën për zbatimin e Projektit përmes nën-projekteve, sipas paragrafit 2 të Nenit 2 të këtij Memorandumi, do të përcaktohet pas shqyrtimit të projekt-propozimeve dhe aplikimeve nga Komuna, vizitave në terren, koordinimit me palët përkatëse dhe hartimit të raporteve për miratim të projekt-propozimeve nga aplikimi.

Neni 4

Përgjegjësitë e MMPHI-së

1. MMPHI, ka përgjegjësi për:

- 1.1. Koordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin për shpërndarjen dhe përdorimin e financimit të nën projekteve në përputhje me rregulloret dhe procedurat sipas Marrëveshjes së kredisë e ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin "Banimi Social Adekuat përmes Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NJMP);

³ Financimi për Komunitet dedikohet vetëm për investime kapitale

- 1.2. Nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi pas aprovimit të propozimeve për nën-projekte, në mes MMPHI-së dhe Komunës, ku do të specifikohen detyrat dhe përgjegjësitë për implementimin e tyre;
- 1.3. Revidimin e nën-projekteve të hartuara nga Komuna;
- 1.4. Mbështetjen dhe asistencën teknike përmes NjMP për Njësitin Implementues të Projektit (NjIP) të Komunës për realizimin e Projektit.

Neni 5 Përgjegjësitë e Komunës

1. Komuna, ka përgjegjësi për:
 - 1.1. Themelimin e Njësitit Implementues të Projektit (NjIP);
 - 1.2. Dorëzimin e propozim projektit pranë MMPHI-së;
 - 1.3. Plotësimin e kushteve sipas dokumenteve të planifikimit dhe të gjitha kushteve të infrastrukturës për lokacionin e përzgjedhur në rastin e ndërtimit të projekteve të reja të banimit social, përfshirë rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, infrastrukturën rrugore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për implementimin adekuat të Projektit përmes nën-projekteve;
 - 1.4. Hartimin e Termave të Referencave dhe Detyrës Projektuese bazuar në Manualin e Zbatimit të Projektit (MZP);
 - 1.5. Zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të tenderimit të Projektimit (Shërbime arkitekturale inxhinierike profesionale-Projektim), koordinimin dhe menaxhimin e hartimit të gjitha fazave të projektit urb-arkitekturual, zgjidhjen urbane, projektin konceptual, projektin ideor dhe projektin kryesor-zbatues ose projekte për renovim dhe rindërtim të njërive të banimit me kompaninë projektuese të kontraktuar dhe financuar nga Komuna;
 - 1.6. Zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të tenderimit për mbikëqyrje të punimeve për ekzekutimin e Projektit përmes nën-projekteve me kompaninë e mbikëqyrjes, të kontraktuar dhe financuar nga Komuna;
 - 1.7. Zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të tenderimit për ekzekutimin e punëve ndërtimore të Projektit përmes nën-projekteve;
 - 1.8. Caktimin me autorizim të një zyrtari në nivel komunal për të lehtësuar komunikimin e palëve për rastet e dorëzimit të Projektit për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore, Certifikatës së Përdorimit dhe procedura tjera relevante të parapara sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi;
 - 1.9. Koordinimin dhe bashkëpunimin në mënyrë efektive me MMPHI përmes NjMP, për mbarëvajtjen e hartimit dhe zbatimit të Projektit duke siguruar në mënyrë transparente të gjitha informatat për zhvillimin e Projektit pa vonesa, brenda afateve

ligjore dhe procedurave për pajisje me Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Certifikatën e Përdorimit, sipas kategorive të Projektit;

- 1.10. Akomodimin e përfituesve deri në përfundimin e punimeve të renovimit;
- 1.11. Dorëzimin e raporteve pranë NjMP-së në kuadër të MMPHI-së, sipas udhëzimeve dhe formateve të raportimit nga MZP;
- 1.12. Administrimin dhe menaxhimin, përfshirë përditësimin e rregullt për të dhënat e përfituesit dhe kërkesave të reja si dhe mirëmbajtjen sipas legjislacionit në fuqi të njësive të banimit të realizuara nga Projekti sipas nën-projekteve.

Neni 6

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

1. Përfituesit do të përzgjidhen sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Mundësi përfitimi do të kenë familjet ose individët me të ardhura të ulëta deri të mesme, si dhe grupet e cënueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe prindërit vetë ushqyes.

Neni 7

Standardet teknike

Standardet dhe normat teknike për Projektin e zhvilluar, do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të përcaktuara për secilin nën-projekt dhe të specifikuara gjerësisht përmes MZP.

Neni 8

Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MMPHI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet apo plotësohet.
2. MMPHI-ja mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast të konstatimit se Komuna nuk i përmbushë obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 9

Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes vete që ky Memorandum zgjidhet me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore, mosmarrëveshja do të zgjidhet përmes mekanizmave të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Numri i kopjeve

Memorandumi është nënshkruar në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum është i vlefshëm nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e suksesshëm të Projektit.
2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim ose përditësim të nevojshëm që ndikon në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Memorandum.

Për Ministrinë e Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës



Liburn ALIU
Ministër i MMPH-së

Për Komunën e Lipjanit



Imri AHMETI
Kryetar i Komunës së Lipjanit

Datë: 23 Dhjetor 2024, Prishtinë

		
Pranuar me:		
Primijeno: 24.12.2024		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-400/01	62823	

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË KOS: SKIFOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE	
Nr.Br.No.	2335/24
Nr. i lq. Br. Ser. No. i g.	-2-
Data/Datum/Date:	23.12.24
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

AMANDAMENT I MARRËVESHJES

për bashkëfinancim në projektin për Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë Banesore Sociale I, Magure, në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Komunës së Lipjanit.

Ky amandament bëhet me qëllim të ndryshimit të marrëveshjes fillestare të bashkëfinancimit Nr. protokoli (FKEE) 2080/24 të datës 12.11.2024, e lidhur ndërmjet Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) dhe Komunës së Lipjanit, si vijon:

Palët:

1. **Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)**, përfaqësuar nga Driton Hetemi, në cilësinë e Drejtorit Menaxhues të FKEE-së.
2. **Komuna Lipjanit** përfaqësuar nga Imri Ahmeti, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Lipjanit.

Duke marrë parasysh:

- Kërkesën e parashtruar nga Komuna e Lipjanit lidhur me shtyerjen e afatit të ekzekutimit të pagesës prej 10% e të vlerës së projektit, sipas Marrëveshjes bazë, me arsyetimin se Komuna e Lipjanit është duke u ballafaquar me ekzekutimin e pagesave përmbartimore të Kontratës Kolektive dhe nuk ekziston asnjë mundësi të realizohet pagesa brenda afatit të përcaktuar me marrëveshje;
- Mirekuptimin nga FKEE për situatën e krijuar buxhetore në Komunën e Lipjanit
- Marrëveshjen fillestare për bashkëfinancim Nr. protokoli (FKEE) 2080/24 të datës 12.11.2024;
- Nevojën për shtyerjen e afatit për ekzekutimin plotë të pagesës prej 10% të vlerës së projektit sipas pikes 1.6.2, neni 1 i marrëveshjes bazë;

Palët bien dakord për ndryshimet në vijim:

Neni 1

Afati për ekzekutimin e pagesës nga Komuna e Lipjanit

Ndryshohet pika 1.6.2 nga neni 1 i Marrëveshjes bazë si vijon:

nga:

1.6.2 Komuna, shumën në vlerë prej 23,353.00 Euro (10% e totalit të investimit) do ta transferojë në llogarinë bankare të FKEE-së: FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË me numër 1110350980010125 në bankën ProCredit Bank (PCB), brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

në:

1.6.2 Komuna, shumën në vlerë prej 12,126.30 Euro (10% e totalit të investimit) do ta transferojë në llogarinë bankare të FKEE-së: FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË me numër 1110350980010125 në bankën ProCredit Bank (PCB), në tremujorin e parë të vitit 2025, por jo më vonë se data 30 Mars 2025.

Neni 2

Pagesa e realizuar nga Komuna e Lipjanit

Pagesa në vlerë prej **11,226.70** Euro, e realizuar nga Komuna e Lipjanit në llogarinë bankare të FKEE-së më 16.12.2024, është reflektuar në nenin 1 të këtij amendamenti, në vlerën e obligimit për pagesë sipas marrëveshjes bazë.

Neni 3

Ndikimi në dispozitat tjera

2.1. Ky amendament nuk ndryshon ndonjë dispozitë tjetër të marrëveshjes fillestare, përveç asaj që është specifikuar në këtë dokument.

2.2 Të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes fillestare mbesin në fuqi dhe janë të zbatueshme.

Neni 4

Fuqia ligjore e amendamentit

Ky amendament hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është pjesë integrale e Marrëveshjes për Bashkëfinancim në mes FKEE-së dhe Komunës së Lipjanit.

Palët:

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Driton Hetemi
Drejtor Menaxhues i FKEE-së

Data: 23/12/24.



Komuna e Lipjanit

Imri Ahmeti
Kryetari i Komunës së Lipjanit





FKEE

FOND I KOSOVËS PËR EFICIENCËN E ENERGJISË
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Procedura e Dokumentimit të Projektit
Projekt: Eficiencë Energjetike në Shtetë
Arkivi - Arkivi - Arkivi
Nr. Dokumenti: 2694/24
Nr. Dokumenti: 167-
Data e miratimit: 30.12.24
FUNDI I KOSOVËS PËR EFICIENCËN E ENERGJISË



Marrëveshja për Shërbime të Energjisë

ndërmjet

Fondi i Kosovës për Eficiencën e Energjisë

dhe

Komuna e Lipjanit

për

**Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në "Shtjefën Gjeqovi"
Janjevë**

Data: 30/12/2024

1.1.5 Certifikimi i zbatimit të MEE;

1.1.6 Prokurimi, menaxhimi i zbatimit të kontratave, menaxhimi financiar dhe raportimi i kërkuar për zbatimin e MEE.

Për auditimin detal të energjisë dhe projektimin teknik përmes procedurave të prokurimit është përzgjedhur ALB Architect SH.P.K për mbikëqyrje teknike të zbatimit dhe monitorimin e periudhës së defekteve të MEE N.N.SH Vizion Project kurse për zbatimin e MEE-ve Euro Besi SH.P.K & Compact Solution SH.P.K. Të gjitha këto aktivitete janë prokuruar dhe kontraktuar nga FKEE dhe do të bashkëngjiten në shtojca pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, para nënshkrimit të kontratave me operatorët ekonomik sipas shtojcës 4. Kurse prokurimi, menaxhimi i kontratave, menaxhimi financiar dhe raportimi i kërkuar për zbatimin e MEE bëhet nga FKEE.

1.2. Cilësia e shërbimeve

FKEE ofron shërbimet sipas pikave 1.1 të këtij neni drejtpërdrejtë dhe/ose përmes kontraktorëve dhe merr përsipër përgjegjësinë e plotë për shërbimet e kryera. FKEE siguron Komunën për: performancë të mirë të të gjitha punëve të kryera nën këtë MShE, funksionimin e duhur të MEE deri në lëshimin e çertifikatës përfundimtare të pranimi të tyre, realizimi i punimeve, dhe instalimi i pajisjeve (a) kanë cilësi të mirë dhe janë funksionale, (b) nuk kanë defekte në dizajn, material dhe punë; (c) janë të përshtatshme për këtë qëllim dhe d) nuk e dëmtojnë mjedisin.

1.3. Koordinimi në mes të palëve

Me qëllim të koordinimit të punëve sipas kësaj marrëveshje, FKEE emëron Diella Shabani si përfaqësues të autorizuar dhe menaxher të projektit, kurse Komuna emëron Besart Zejnullahu si përfaqësues të autorizuar. Secila palë do të njoftojë me shkrim palën tjetër për ndryshimet në lidhje me përfaqësimin e autorizuar në këtë marrëveshje.

1.4. Komisionimi dhe Pranimi i Shërbimeve

Shërbimet sipas kësaj marrëveshjeje konsiderohen të përfunduara pas çertifikimit përfundimtar të punëve, që confirmohet nga nënshkrimi i të dy palëve në çertifikatën e pranimi të përkohshëm dhe atë përfundimtar.

Pas çertifikimit përfundimtar (çertifikatës së pranimi përfundimtar), një seri e plotë e dokumenteve në lidhje me projektin, siç janë: Kontratat dhe amandamentet, Raporti i Auditimit të Energjisë, Projektin Detal, Faturat lidhur me projektin dhe urdhër pagesa, Projekti i Zbatuar, çertifikatat e pranimi të përkohshëm dhe përfundimtare, raportin final dhe të gjitha çertifikatat, manualët e produkteve të MEE te raportet e testimit të sistemeve do t'i sigurohen Komunës.

Bartja e pasurisë tek komuna do bëhet përmes një marrëveshje të veçantë, jo më vonë se tre (3) muaj pas përfundimit të periudhës së defekteve.

- 1.6.8 Data e fillimit të detyrimeve të pagesës kthimin e investimit është dita e parë e muajit të parë pas përfundimit të tremujorit kalendarik, gjatë së cilës u nënshkrua Çertifikata e Pranimit të Përkohshëm. Pagesat do të bëhen jo më vonë se data 30 e muajit të fundit të kuartalit kur është bërë detyrimi për pagesë.
- 1.6.9 Periudha e kthimit dhe/ose shumat e kësteve mund të ndryshojë me marrëveshje në mes palëve nga ajo e dakorduar në raportin e auditimit të energjisë, me kusht që shuma e plotë t'i paguhet FKEE-së për një periudhë jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, siç përcaktohet në nenin 37 të Ligjit për Eficiencë të Energjisë.
- 1.6.10 Komuna mund të shlyejë plotësisht investimin në çdo kohë para përfundimit të Planit të kthimit të investimeve. Për këto raste FKEE nuk ngarkon Komunën me ndonjë tarifë shtesë.
- 1.6.11 Në rast të shkeljes së planit të pagesave, vonesat në pagesa (mos pagesa ose pagesa e vonuar), Komuna do t'i paguajë FKEE-së një ndëshkim në shumën prej 0.1% në ditë të shumës së vonuar, por jo më shumë se 10% të shumës së tërësishme të investimit.
- 1.6.12 Nëse Komuna paguan detyrimin pas vonesave si një transfer të vetëm, atëherë FKEE fillimisht merr shumën për ndëshkim, e pastaj shumën nga kostoja e investimit.
- 1.6.13 Çdo tremujor, FKEE dhe Komuna bëjnë barazimin e pagesave. Në fund të çdo viti kalendarik, FKEE njofton Komunën për pagesat e realizuara gjatë vitit dhe detyrimet e pashlyera të prapambetura/vonuara (kostoja e investimit dhe gjoba) dhe pagesat për vitin e ardhshëm.
- 1.6.14 Kthimi i investimit konsiderohet i përfunduar me koston e fundit të paguar nga Komuna

1.7. Testi i performancës

FKEE mund do të aranzhojë një test të performancës në komisionimin e punëve, aty ku e shihet nevojshme, për të verifikuar punët e kryera dhe kursimeve për raportime dhe analiza. Shtojca 6 përfshinë një përshkrim të testit të performancës.

1.8. Standardet e performancës Mjedisore dhe Sociale

